



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Zhvillimit Rajonal*  
*Ministarstvo za Regionalni Razvoj*  
*Ministry of Regional Development*

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Ministria e Zhvillimit Rajonal shpall:

## Konkurs

### Lëvizje brenda kategorisë

*Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.*

<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Drejtor i Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio – Ekonomike Rajonale
<b>Klasa e pozitës</b>	Drejtues i Mesëm 1
<b>Koeficienti/Paga</b>	10
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Data e njoftimit</b>	27/12/2022
<b>Afati për aplikim</b>	11/01/2023 - 18/01/2023
<b>Institucioni</b>	Ministria e Zhvillimit Rajonal
<b>Departamenti</b>	Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio - Ekonomike Rajonale
<b>Divizioni</b>	
<b>Vendi i punës</b>	Prishtinë
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00010649
<b>Kodi</b>	RPC0004318



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

1. Udhëheq dhe koordinon me aktivitetet e departamentit dhe Përgatit plane lidhur me komunikimin e komunave brenda rajoneve, me qëllim të stimulimit të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;
2. Zhvillon aktivitete bashkërenduese me komunat për planifikimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal, duke forcuar lidhjet reciproke ekonomike dhe shoqërore, si dhe rritjen e zhvillimit të balancuar të rajoneve;
3. Zhvillon sistemin për matjen dhe monitorimin e performancës socio-ekonomike rajonale të balancuar,
4. Krijon dhe mirëmban sistemin e raportimit të dhënave lidhur me zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar poashtu zhvillon aktivitetet për përgatitjen e profileve të rajoneve socio-ekonomike në Kosovë;
5. Bashkëpunon me ministritë e linjës dhe institucionet tjera, lidhur me hartimin e analizave për zhvillim socio-ekonomik të balancuar;
6. Zhvillon aktivitetet për përgatitjen e profileve të rajoneve socio-ekonomike në Kosovë;
7. Planifikon dhe zhvillon treguesit për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik të balancuar rajonal, përgatit analiza për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar
8. Detyra tjera siç kërkohen nga Sekretari i Përgjithshëm.

## 2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

---

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to : Ekonomikë, Juridik, Filozofik.

- Kualifikime të posaçme formale:
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese.

## 4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

---

- Aftësi të larta organizative, drejtuese dhe formulim politikash;
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive të nivelit të lartë analitik dhe zgjidhjes së problemeve;
- Njohuri të gjera lidhur me fushën e përgjegjësisë së departamentit, menaxhimin e sistemit buxhetor dhe të shërbimit civil;



## 5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

---

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

## 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 25/01/2023, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

---

- 07.02.2023 në MZHR -Salla e takimeve kati X në ora 10:00

## 8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

---

- Njohuri të mira të legjislacionit në fuqi;
- I aftë të punojë i pavarur dhe si pjesëtar i ekipit (punë ekipore);
- Aftësi të mira të udhëheqjes dhe ndër-personale, të orientuara drejt hollësive, aftësi të mira të organizimit dhe menaxhimit të kohës;
- Aftësi të dëshmuara të vizionit strategjik, aftësi planifikimi dhe aftësi në implementimin e planeve;
- Aftësi të mira të komunikimit;
- Njohuri të gjuhëve zyrtare/ e preferuar njohja e gjuhës angleze;
- Shkathtësi të punës në kompjuter (Microsoft aplikacioneve, internetit, SPSS,);

## 9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Intervist

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



## 12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

